



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019), nenit 40 dhe nenit 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtruesi SHTPSH SHPKNJ Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në vazhdimin e seancës së 46-të të mbajtur me datë 19 shkurt 2021 morri

VENDIM

Procedura për lëndën nr.12-3439 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit nr. 12-3439/1 me datë 05.07.2019, dorëzuar nga parashtruesi SHTPSH SHPNJP, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën me numër 12-3439 nga viti 2019, në rastin e lëndës është vepruar nga organ tjetër kompetent dhe nuk janë vërtetuar akuzat e lëndës.

Lënda me numër 12-3439 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi të dorëzohet Vendimi i KSHPK me sqarimin

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

SQARIM

Lënda me numër 12-3439 nga viti 2019 është formuar në bazë të denoncimit nr. 12-3439/1 me datë 05.07.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, nga parashtrues SHTPSH SHPKNJ

Në denoncimin e lëndës flitet për akuza për parregullsi dhe punë joligjore, si dhe për keqpërdorime në detyrën zyrtare, ndikim dhe diskriminim të subjektit në procedurën për furnizime publike në ISHP Klinika universitare për Shkup, realizuar nëpërmjet shpalljes publike numër me datë 28.03.2019, për dhënie të kontratës për furnizime publike të mallrave – paisje mjekësore për laboratorin për elektrofiziologji dhe elektrostimulim të zemrës (elektristimulues, defibrilator, elektroda, katetra, dhe tjera)

Në shtojcë të denoncimit është dorëzuar edhe kopje nga dokumentacioni: propozime dhe komentare, Procesverbal nga dialogu teknik i realizuar, dokumentacion i tenderit.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës, KSHPK i merr parasysh akuzat e parashtruesit dhe në drejtim të përcaktimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri tek institucionet kompetente për mbledhje të të dhënave, informacioneve dhe dokumentave në lidhje me akuzat e lëndës. Me kërkesë së KSHPK janë dorëzuar informime me shtojcë dokumentacion dhe pas rishikimit të dokumentacioni të plotë me të cilën disponon për rastin e lëndës nga ana e KSHPK është caktuar gjendja faktike vijuese.

- Në rastin konkret, bëhet fjalë për procedure për furnizime publike të realizuar nga ISHP Kliniak universitare për Shkup pas shpalljes publike numër me

datë 28.03.2019 për dhënje të kontratës për furnizime publike të mallrave – mjete mjekësore për laboratorin për elektrofiziologji dhe elektrostimulim të zembrës (elektrostimulues, defibrilator, elektroda, katetera dhe tj.) në procedurë me dialog teknik të realizuar, kurse drejtori i ISHP të lëndës e ka nënshkruar Vendimin për realizimin e procedurës së përmendur për furnizime publike si dhe vendimin për zgjedhje të ofertës.

Nga ana e parashtruesit të denoncimit ekziston dyshim për legjitimitetin e procedurës së lëndës për furnizime publike përshkak të faktit se me atë që është material harxhues për aparaturat të cilat ende nuk janë blerë, gjë që sipas akuzave të lëndës, është e kundërt me ligjin kurse furnizimi publik i lëndës është skandaloz përshkak të asaj që nuk mundet të arsyetohet furnizimi i mjeteve dhe materialeve për punë me të cilën organi i kontraktuar disponon. Gjegjesisht, në dokumentacionin e tenderit, organi i kontraktuar ka shënuar vërejtje se materialet, lëndë e furnizimit nr. 34 deri 43, janë në korelacion të drejtë me furnizimin paraprak të apaturës nëpërmjet Ministrisë së shëndetësisë dhe janë vënë nën pikën Buxhet me kusht, që don të thotë se nëse nuk blihet aparatura e nevojshme për këto materiale, të njëjtat nuk do të tërhiqen gjegjesisht nuk do të porositen dhe me atë, të specifikacionin e tenderit – lënda e furnizimit pjes 34, 35 dhe 36, janë vërtetuar karakteristikat e caktuara të kateterëve që të jenë kompatibil për ”3D mapping system” të apaturës edhe pse në momentin nuk dihet se për çfarë apaturë bëhet fjalë.

Në procedurën e lëndës për furnizime publike, nga ana e SHTPSH SHPKNJ si operator ekonomik cili dëshiron të fiton mundësi për pjesëmarrje në procedurë, deri tek komisioni për realizimin e furnizimit publik të lëndës, janë dorëzuar propozime dhe vërejtje për dialogun teknik në lidhje me më shumë Pjesë të versionit të punës të specifikacioneve teknike dhe janë dhënë komentare në lidhje me definimin e specifikave teknike për furnizime në Pjesën 34, 35 dhe 36, për atë se ajo ka qenë përgaditur me parametra të kufizuar të cilët udhëzojnë në prodhues konkret kurse në përshkrimin e prodhimit – kateterë të cilët ishin lëndë të furnizimit është numëruar dhe emri i brendit të prodhimit (..... dhe me çka prejudicohet se çfarë sistemi duhet të blihet, me favorizimin e një prodhuesi gjegjesisht është e mundur paraprakisht të supozohet se për cilin prodhim është bërë specifikimi, me të cilën është kufizuar konkurrenca dhe i është pamundësuar operatorëve ekonomik të ken mundësi për pjesëmarrje të barabartë në procedurën për furnizime publike.

Komisioni për realizimin e furnizimit publik nuk i ka pranuar vërejtje e dhëna dhe propozimet kurse në lidhje me komentet e dhëna për Pjesën 34, 35 dhe 36 është sqaruar se emri i prodhimit i shënuar në përshkrimin e tij nuk paraqet lloj të kateterëve por është vetëm përkthim nga anglishtja ashtu që organi i kontraktuar nuk udhëzon dhe nuk favorizon prodhues konkret ose prodhim

Parashtruesi i denoncimit mendon se në furnizimin publik të lëndës nga ana e organit të kontraktuar qëllimisht është duhur të definohen specifikat teknike për kateterët me çka në rastin konkret nga ana e ISHP Klinika universitare është vepruar në kundërshtim me Ligjin për furnizime publike, nenin 82 paargrafi 8, ku është shënuar se organi i kontraktuar nuk ka të drejtë të definon specifika teknike të cilat udhëzojnë për prodhimin konkret, proces të caktuar ose brend tregtar, patent, lloje ose prejardhje specifike të mallit me qëllim të favorizimit ose eliminimit të operatorit të caktuar ekonomik, me çka pason përgjegjësi penale.

Në denoncimi e dorëzuar nuk ka informacione se vallë në lidhje me të shënuarën si palë e pakënaqshme, parashtruesi u drejtua deri në organ tjetër kompetent (denoncim i dorëzuar, ankes ose kërkesë e dorëzuar për mbrojtje ligjore deri tek Komisioni shtetëror për ankesa nga furnizimet publike dhe të ngjashme) ose ka kërkuar mbrojtje administrative – juridike, që don të thotë se vallë a ka nisur process gjyqësor në lidhje me favorizimin, gjegjësisht diskriminimin. Sipas parashtruesit të denoncimit, me miratimin dhe realizimin e këtij furnizimi të lëndës, drejtori i ISHP Klinika universitare të përmendur ka kryer keqpërdorim të detyrës zyrtare, shkelje flagrante të dispozitave ligjore edhe të Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të intersave neni 38 paragrafi 2 me diskriminim të subjektit në procedurën për furnizime publike, prandaj kërkon nga KSHPK të vepron për akuzat e lëndës dhe të ndërmer masa adekuate dhe aktivitete në përputhje me kompetencat e veta ligjore.

KSHPK, me qëllim të vërtetimit të akuzave të lëndës, bëri inspektim në sistemin elektronik për furnizime publike (SEFP) në Byron për furnizime publike me çka erdhi deri tek njohuritë vijuese:

- Procedura për furnizime publike të lëndës në kontratën: paisje mjekësore për laboratorin për elektrofiziologji dhe elektrostimulim të zemrës (elektrostimulues, defibrilator, elektroda, kateterë dhe tjera) është realizuar nga ana e ISHP Klinika universitare për Shkup me numër të shpalljes,
- Lënda e kontratës së furnizimit publik të lëndës ka qenë e ndarë në pjesë siç është definuar në specifikat teknike, kriteret për ndarje të marrëveshjes për furnizim publike ka qenë çmimi më i ulët, kurse kontrata për furnizime publike do të ndahet në procedurë të hapur e cila do të përfundonte me aukcion elektronik si fazë përfundimtare e procedures.
- Në dokumentacionin e tenderit organi i kontraktuar në fund të II – Teknikat specifike ka shënuar Vërejtje ”Materialet të cilët janë shënuar nga Pjesa 34 deri në 43 janë në korelacion të drejtë me furnizimin paraprak të aparateve nëpërmjet Ministrisë së shëndetësis, dhe janë shënuar në pikën Buxhet me kusht, që don të thotë se nëse nuk blihen aparatet e nevojshme për këto materiale, të njëjtat nuk do të tërhiqen, gjegjësisht nuk do të blihen”.
- Në procedurën e lëndës për furnizime publike janë nënshkruar tri kontrata dhe atë: 1) Kontratë numër 03-34/44 me datë 23.07.2019 kontraktuar me Ndërmarrjen për prodhim, tregëti dhe shërbime eksport-import për pjesët 3, 13, 23, 24, 25, 26 dhe 33; 2) Kontratë numër 03-334/45 me datë 23.07.2019 kontraktuar me Shoqërinë për shërbime SHPKNJP për Pjesën 9; dhe 3) Kontratë numër 03-334/46 me datë 23.07.2019 kontraktuar me Shoqërinë për tregëti dhe shërbime SHPK për pjesën 2, 6, 8, 10, 14, 16, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41 dhe 42;
- Me datë 30.10.2019, nga ana e organit të kontraktuar është publikur Lajmërim për anulim të procedures për dhënje të marrëveshjes për furnizime publike në lidhje me shpalljen numër 6/2019, në të cilën informojnë se procedura është anuluar për pjesën: 1, 4, 5, 7, 11, 12, 15, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 43 me arsyje se nuk është dhënë asnjë ofertë e pranueshme;
- Byroja për furnizime publike, me kërkesë të KSHPK, me datë 07.09.2020 informon se në lidhje me kërkesën që të bëjë inspektim mbi ligjshmërinë e procedures për furnizime publike dhe kontrollim administrativ në përputhje me kushtet nga Ligji për furnizime publike në ISHP Klinika universitare ISHP Klinika universitare për Shkup në lidhje me procedurën për furnizime publike të lëndës, Byroja nuk ka kompetenca të

vepron në drejtim të bërjes së kontrollit në procedurën e lëndës për furnizime publike për arsye se nuk janë plotësuar kushtet nga neni 172 nga Ligji për furnizime publike, gjegjësisht për arsye që Byroja për furnizime publike ka bërë kontroll administrative para dërgimit të vendimit për zgjedhje ose anulim të procedurës, kurse në lidhje me procedurën e lëndës nga ana e organit të kontraktuar janë miratuar vendimet dhe me datë 23.07.2019 është nënshkruar marrëveshja ndërmjet organit të kontraktuar dhe oferdhënsit më të volitshëm të zgjedhur.

- Pas kontrollimeve të bëra nga KSHPK, erdhën deri në njohuri se në lidhje me procedurën e lëndës është vepruar nga ana e Komisionit shtetëror për ankesa për furnizime publike, duke vendosur për ankesën e të ankuarit - SHPKNJP deklaruar kundër Vendimit për zgjedhje të oferdhënsit më të volitshëm nr. me datë 24.06.2019 për furnizime me mallra – mjete mjekësore për laboratorin për elektrofiziologji dhe elektrostimulim të zemrës (elektrostimulues, defibrilator, elektroda, kateterë etj.) të organit të kontraktuar ISHP Klinika universitare për – Shkup, ka marrë Vendim me numër me datë 18.07.2019, me të cilën ankesa refuzohet si e pa bazë.

Kjo don të thotë se parashtruesi i denoncimit, pas dorëzimit të denoncimit deri tek KSHPK në lidhje me procedurën e lëndës për furnizime publike, ka dorëzuar ankesë deri tek organi kompetent sepse si pjesëmarrës në procedure mendon se e njëjta është bërë me lëshime të rëndësishme nga ana e organit të kontraktuar gjatë evaluimit të ofertave, furnizimi i lëndës është shoqëruar me në varg të parregullsive në ndëmerrien e veprimeve nga ana e organit të kontraktuar ndër të cilat theksohet edhe akuzat e denoncimit (ajo është: se organi i kontraktuar nuk ka të drejtë të definon specifika teknike të cilat udhëzojnë drejt prodhimit konkret ose brendit tregëtar me qëllim të favorizimit ose eliminimit të operatorit të caktuar ekonomik ose mallrave të caktuara).

Në sqarimin e Vendimit pas dhënjes së ankesës, detalisht është sqaruar veprimi i Komisionit shtetëror për ankesa të furnizimeve publike, është mbledhur dokumentacioni i nevojshëm dhe është bërë mbikqyrje në Sistemin elektronik për furnizime publike për realizimin e procedurës për furnizime publike, me çka është vërtetuar se ankesa e dhënë është e pabazë dhe se organ i kontraktuar ka vepruar në përputhje me nenin 140 paragrafi 7 nga Ligji për furnizime publike në përputhje i cili ofertat e papranueshme nuk i ka evaluuar dhe me të drejtë ofertën e parashtruesit të ankesës e ka rrefuzuar si ofertë të papranueshme me arsye që nuk i ka plotësuar në tërësi kushtet e kërkuara të shënuar në specifikat teknike.

Në lidhje me vërejtjen e përmendur, Komisioni shtetëror vërtetoi se organi i kontraktuar ka marrë Vendim për realizim të procedurës për furnizim nr. me datë 19.03.2019 me të cilën janë sigurua mjetet financiare për procedurën e lëndës me çka nënkuphton edhe për materialet e shënuara nga pjesa 34 deri pjesën 43 nga furnizimi publik i lëndës. Komisioni shtetëror vërtetoi se në specifikat teknike në vërjetje është shënuar se materialet nga pjesa 34 deri në pjesë 43 të furnizimit të lëndës janë për blerjen paraprake të aparatit nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë. Në faqen 18 nga sqarimi i Komisionit shtetëror është theksuar se nga ana e organit të kontraktuar është dhënë shprehje (deklarim) dhe plotësim në lidhje me ankesën e dorëzuar në të cilën në mes tjerash theksohet se organi i kontraktuar në qëndrimin e tij gjatë definimit të specifikave teknike nuk është bërë fjalë për definim të brendit tregëtar, por se bëhet fjalë për përshkrim të tipit të prodhimit. Në fund të vendimit është dhënë udhëzim për mjetet

juridike, se në përputhje me nenin 230 nga Ligji për furnizime publike dhe nenin 20 nga Ligji për mosmarrveshje administrative, kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të dorëzon padi deri tek Gjykata administrative e Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

- KSHPK përshkak të përcaktimit të gjendjes faktike për lëndën e hapur, në kuadër të kompetencave ligjore, kërkoi nga Komisioni për mbrojtje të konkurrencës mendim profesional në lidhje me atë se vallë definimi i specifikave teknike për pjesën 34, 35 dhe 36 në procedurën për dhënje të kontratës për furnizimin publik të lëndës nga ana e ISHP Klinika universitare për Shkup e kufizon konkurrencën e tregut?

Me datë 05.11.2020, nga ana e Komisionit për mbrojtje të konkurrencës është marrë informim me të cilën informohet KSHPK se komisioni ka vepruar në kërkesën e KSHPK dhe në senacën e mbajtur me datë 04.11.2020 ka marrë këtë: "me shënimin në Shpallje për dhënje të kontratës për furnizime publike nëpërmjet procedurës së hapur nr. 6/2019 (mjete mjekësore për laborator për elektrofiziologji dhe elektrostimulator për zemër) të ISHP Klinika universitare për në pjesën 34, 35 dhe 36 në kërkesën "kateter ablativ kompatibil me mapping sistem 3D i cili punon në fushë elektromagnetike me precizitet 1mm ose ekuivalent, kateter kompatibil me mapping sistem 3D i cili punon me precizitet 1mm ose ekuivalent dhe kateter kompatibil me mapping sistem 3D i cili punon me precizitet 1mm ose ekuivalent, nuk kufizohet konkurrenca, gjegjësisht të njëjtat nuk kanë ndikim mbi konkurrencën e tregut."

Në sqarimin e mendimit të dorëzuar, Komisioni për mbrojtje të konkurrencës thekson se gjatë miratimit të mendimit është marrë parasyshë përgjigjja e marrë nga kryetari i Komisionit profesional i ISHP të përmendur d-r, në të cilën është dorëzuar sqarim se kriteret e shënuara për kompatibilitet me mapping sistem 3D ka qenë i nevojshëm përshkak të kompatibilitetit me mapping sistemin i cili blihet në procedurë tjetër nga Ministria e shëndetësisë, kurse në mënyrë plotësuese në shkrimin theksohet se në përshkrimin dhe mendohet në formën, ajo është në kateterin cirkular, gjegjësisht kateter me 5 krahë përkatës, kurse e njëjta ka të bëjë edhe me termin catheter, gjegjësisht se nuk ka të bëjë me definimin e brendit të prodhimit por me formën e prodhimit, si dhe është potencuar se tek çdo pikë diskutabile në përshkrimin e karakteristikave teknike ka qëndruar "ose ekuivalent".

Në bazë të kësaj gjendje faktike të caktuar, KSHPK konstaton se në rastin e lëndës është vepruar nga organ tjetër kompetent i cili është kompetent të vepron – Komisioni shtetëror për ankesa për furnizime publike, i cili ka vepruar për ankesën e dhënë nga parashtruesi i denoncimit si pjesëmarrës i pakënaqur në procedurën e lëndës për furnizime publike, me çka nga ana e këtij organ kompetent është caktuar se ankesa e parashtruar ka qenë e pabazë dhe se organi i kontraktuar ka vepruar në përputhje me dispozitat e Ligjit për furnizime publike. Njëherit, për rastin konkret nga ana e KSHPK është mbledhur edhe mendim profesional nga organi kompetent – Komisioni për mbrojtje të konkurrencës nga i cili është dorëzuar mendim se me publikimin e specifikave teknike në procedurën e furnizimit publik të lëndës nga ana e ISHP Klinika universitare për Shkup, nuk kufizohet konkurrenca gjegjësisht të njëjtat nuk kanë ndikim mbi konkurrencës e tregut. Duke pasë parasyshë të konstatuarën, KSHPK përfundon se në rastin e lëndës është vepruar nga organ tjetër kompetent dhe nuk janë vërtetuar

akuzat e lëndës, me çka vlerëson se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për rastin e lëndës, procedura për lëndën të ndërpritet kurse lëndë të mbyllet dhe të arkivohet.

Në bazë të tërë kësaj të shënuar më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

Dorëzuar deri tek: Arkiva dhe Parashtruesi

Pas përfundimit të KSHPK

Përpunoi: J. C., këshilltarë

Miratoi: m-r Sh. S., anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËROР ПЁР
PARANDALIM ТЁ KОРРУПСИОНИТ**
Zëvendës-Kryetarë: Shemshi Sallai

